

VENDIM
Nr. 1070, datë 23.12.2015

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË
TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS TË PRONËS “ISH - SHKOLLA E MESME
TEKNOLOGJIKE”, TIRANË, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 834,
DATË 13.12.2006, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË
PJESSHME TË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, QË
JANË NË JURIDIKSIONIN TERRITORIAL DHE ADMINISTRATIV TË BASHKISË
TIRANË, TË QARKUT TË TIRANËS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10, 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës të pronës së paluajtshme shtetërore “Ish - Shkolla e Mesme Teknologjike”, të ndodhur në zonën kadastrale nr. 8260, TR-Q, R-5, 6, e cila përfshin numrat e pasurive 1/8, 1/249, 1/136 dhe 1/130, pjesa e konturuar, me sipërfaqe totale 553.88 (pesëqind e pesëdhjetë e tre pikë tetëdhjetë e tetë) m², për t’ua përdorur për nevoja urbanistike, sipas planimetrisë bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Prona e përmendur në pikën 1, të këtij vendimi, të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, e cila i bashkëlidhet vendimit nr. 834, datë 13.12.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së pjesshme të inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të Bashkisë Tiranë, të qarkut të Tiranës”.

3. Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës nuk mund ta tjetërsojë pronën e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ose t’ua japë atë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen ministri i Transportit dhe Infra-strukturës, ministri i Punëve të Brendshme dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



